



|                                                                                     |                                    |
|-------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO                             |                                    |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |                                    |
| Dep.<br>Dep.<br>Dep.                                                                | Nr. Prot.<br>Br. Prot.<br>Prot No. |
| 2-0/08K                                                                             | 01-4953/15                         |
| Nr. f. pag.<br>Broj. stranica<br>Nr. pages                                          | Data<br>Datum<br>Date              |
| 02                                                                                  | 30.12.2015                         |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.12.2015, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK– 03-02-1764/15, për z. Emrush Hyseni – U.D. Drejtor i Ndërmarrjes Publike Komunale “Sportmarketing” Sh.a., për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi për z. Emrush Hyseni – U.D. Drejtor i Ndërmarrjes Publike Komunale “Sportmarketing” Sh.a., është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.**

Dyshimet për konflikt interesi sipas paraqitësit të rastit kanë qenë sepse z. Hyseni, në ushtrimin e funksionit të UD Drejtorit të ndërmarrjes “Sportmarketing”, ushtron edhe funksionin e shefit të kontabilitetit. Po ashtu vëllai i z. Hyseni është i punësuar në këtë ndërmarrje dhe dyshimi për konflikt interesi, sipas paraqitësit të rastit, është se z. Hyseni mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në punën e vëllait të tij.

Bazuar në këto informata zyrtarët e AKK-së kanë filluar mbledhjen e të dhënave me ç ‘rast kanë organizuar edhe takim me z. Hyseni. Ai ka deklaruar se është i punësuar në ish BVI-a për Kulturë Fizike (nga data 20.10.1982), ndërsa më vonë e transformuar në Ndërmarrjen “Sportmarketing” sh.a. dhe vëllai i tij e ka filluar punën në këtë Ndërmarrje me datë 12.07.2001.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ka paraparë konfliktin “rast për rast” të interesave. Dispozitat e nenit 13 të këtij ligji përcaktojnë se:

1. Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur.
3. Vetë deklarimi si rregull bëhet ushtrimin e këtyre funksioneve nuk e ka ndaluar.

Ky edhe është rekomandimi që AKK i ka bërë z. Hyseni, që gjatë ushtrimit të funksionit të U.D. Drejtorit, të tërhiqet nga vendimmarrja ashtu siç parashihet me dispozitat e lart cituara.

Andaj, bazuar në këto të dhëna dhe nenin 18 (pika 10) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, duke marrë parasysh të gjitha faktet që i posedojmë në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit për këtë rast, vlerësojmë se nuk ka konflikt faktik të interesit i cili do t'i ndalonte z. Hyseni ushtrimin e funksionit publik të U.D. Drejtorit në Ndërmarrjen “Sportmarketing” sh.a.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

